



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 341/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik (KDTP), në Prizren, për shkak të mungesave të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e pas afatshme ankesa e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KDTP), dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 10.06.2014, nga subjekti politik KTAP në Prizren, në të cilën thekson se në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme në Republikën e Kosovës sipas të dhënave në qytetin e Prizrenit ka pasur tentime dhe manipulim me procesin zgjedhor sidomos nga ana e përfaqësuesve të KDTP në këto qendra të votimit: Qendra e Votimit "Mustafa Bakia", "Motrat Qiriazhi", "Gjon Buzuku" dhe "Remzi Ademaj" dhe me këtë rast është shkelur neni 80 dhe neni 100 i Ligji Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Po ashtu ky proces i manipulimit ka filluar që në hapjen e fushatës zgjedhore dhe ka vazhduar edhe brenda institucionit të KQZ me rastin e emërimit të kryesuesve të KVV-së në Mamush. Duke u mbështetur në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës kërkojnë nga PZAPI që të marrpër rivotimin e të gjitha kutive të votimit në Qendrën e Votimit "Mustafa Bakiu", "Motrat Qiriazhi", "Gjon Buzuku" dhe "Remzi Ademaj" në komunën e Prizrenit.

PZAP-i, shqyrtoi afatshmerinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pas afatshme

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se ankesa është e pas afatshme ngase afati për të parashtruar ankesë në PZAP për të gjitha parregullsitë që lidhen me ditën e votimit është definuar me nenin 119.1 të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Personi që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelle ligjore për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”*. Ndërsa ankesa në fjalë është parashtruar në PZAP me datë 10.06.2014 në ora 14:57, që nënkupton se është pas afatit të përcaktuar sipas dispozitës së sipërhënuar, andaj duke u bazuar nenin 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 341/2014 më datën 12.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.